



ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS
KOSOVA CHAMBER OF ADVOCATES
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA

V.KA.nr.12-5/2022

KOMISIONI PËR ANKESA I ODËS SË AVOKATËVE TË KOSOVËS, në Kolegjin e përbërë prej Edona Sina – Kryesuese e Kolegjit, Kadri Sylaj dhe Luljeta Jashari Hertica – anëtarë, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Vjollca Ajeti nga Zyra Disiplinore e OAK-së, duke vepruar sipas ankesës së ushtruar nga Prokurori Disiplinor i OAK-së me nr.14-2/2022 të datës 04.07.2022, në seancën e datës 21.07.2022, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar, ankesa e ushtruar nga Prokurori Disiplinor i OAK-së me nr.14-2/2022 e datës 04.07.2022.

VËRTETOHET Vendimi i Komisionit Disiplinor V.KD.nr.12-1/2021 i datës 23.05.2022.

A r s y e t i m

Komisioni Disiplinor i OAK-së me vendimin V.KD.12-1/2022, të datës 23.05.2022, ka hudhur Propozimin e ZPD-së të OAK-së me nr.19-3/2021 të datës 22.04.2022 dhe ka pushuar procedurën disiplinore ndaj Av. [Emri i Avoktit], për shkak të shkeljes disiplinore nga neni 118 pika 1.15 i Statutit të OAK-së lidhur me nenin 36 pika a. Të KEPA-së.

Kundër këtij vendimi, Prokurori Disiplinor ka parashtruar ankesë me pretendimet se:

Komisioni disiplinor nuk e ka vërtetuar në tërësi gjendjen faktike, sepse e paraqitura ka bërë shkelje të Kodit të Etikës për Avokatë dhe Statutit të OAK-së, sepse ju ka çasur objektit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë në kundërshtim me Vendimin nr.284/21 të datës 03.02.2021 të Këshillit Drejtues të Odës së Avokatëve të Kosovës, me ç'rast ka kryer shkelje të rëndë. Sipas Prokurorit disiplinor me veprime të tilla shkelet autoriteti i OAK-së në raport me anëtarësinë e vet dhe në raport me institucionet tjera, dhe se e paraqitura është dashur ta respektoj vendimin për bojkot të Prokurorisë, duke konsideruar se faturën e shpenzimeve, ka mundur ta dërgoj përmes postës.

E paraqitura [Emri i Avoktit] ka parashtruar përgjigje në ankesë me pretendimet se:

Inicimi i procedurës disiplinore ndaj saj nga ana e ZPD-së bie ndesh me në mënyrë flagrante me Ligjin nr.03/L118 për Tubime Publike, pasi që sipas këtij ligji askush nuk mund të obligohet-detytohet të bëj bojkot apo formë të ngjashme proteste ndaj kujdo qoftë. Ndër të tjera thekson se atë ditë se nuk ka marrë pjesë në punë profesionale në emër të ndonjë klienti por thjeshtë ka dorëzuar faturën nr.03/2021 për punën e kryer në polici, dhe se nga vetë OAK është ftuar përmes telefonit që të shkoj në përfaqësim të rastit sipas detyrës zyrtare.

Pas analizimit të të gjitha pretendimeve në ankesë dhe shkresave të lëndës, Komisioni i Ankesave vlerësoi se: **ankesa e ushtruar nga i Prokurori Disiplinor është e pabazuar.**

Në rastin konkret e paraqitura nuk ka shkuar në Prokurori për të përfaqësuar ndonjë klient apo për ndonjë shërbim juridik profesional të ngjashëm, ajo ka shkuar për të kryer një veprim administrativ që ka të bëjë me dorëzimin e faturës pasi që ka qenë dita e fundit për dorëzim në atë muaj. E paraqitura e ka pasur të domosdoshme që të shkojë pasi që dorëzimi i faturave bëhet në mënyrë fizike në institucione, sepse një kopje e faturës mbetet në institucion, në këtë rast në prokurori dhe kopja tjetër e protokoluar dhe e nënshkruar nga zyrtari i financave mbetet tek avokati. E paraqitura thjeshtë ka shkuar në prokurori për të drejtën e saj legjitime për kompensim për përfaqësim të rastit sipas detyrës zyrtare në polici, rast për të cilin ajo është ftuar nga vetë OAK përmes telefonit. Sa i përket vërtetimit të gjendjes faktike, nuk është kontestuese se e paraqitura ka shkuar në objektin e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, mirëpo Komisioni i Ankesave nuk i konsideron këtë veprim si shkelje disiplinore, duke marrë parasysh arsyen, veprimin konkret dhe prej nga ka rrjedhur çasja e saj në objektin e Prokurorisë – nga thirrja e vetë OAK-së për angazhim ex-officio, duke e ditur paraparakisht se për çdo përfaqësim në polici, kompensimet e avokatëve dorëzohen në Prokurori.

Komisioni i Ankesave analizoi dhe mori për bazë të gjitha pretendimet e tjera ankimore por vlerësoi se të njejtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe. Andaj mbështetur në arsyet e lartcekura, Komisioni i Ankesave si shkallë e dytë, gjeti se Komisioni Disiplinor si shkallë e parë, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje disiplinore. Ashtu që sipas nenit 110 par.1 dhe par.2 të Statutit të OAK-së, si dhe në bazë të nenit 46 par.1 pika 1.1, 1.2, 49, 52 të Rregullores për Procedurën Disiplinore për Avokatë dhe Praktikantë, vendosi sikur në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI I ANKESAVE I ODËS SË AVOKATËVE TË KOSOVËS

PRISHTINË, V.KA.nr.12-5/2022, i datës 21.07.2022

Kryesuesja,

Avokate Edona Sina,



Vendimi i Komisionit të Ankesave është i formës së prerë, kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.